



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 1090 Prot.
Tiranë, më 25/03 /2024

Lënda: Mbi zbatimin e vendimit nr. 1/2023 të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë

Drejtuar: **Znj. Lindita Nikolla**
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Në vëmendje: Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë
Delegacionit të Bashkimit Europian në Tiranë
Ambasadës së Britanisë në Tiranë
Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Tiranë
Prezencës së OSBE-së në Tiranë

E nderuar Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në datën **20.06.2022**, në bazë të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, 1/10 e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, anëtarë të Grupit Parlamentar të PD, i janë drejtuar Kuvendit me mocion për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes së Kuvendit, Olta Xhaçka, duke pretenduar ushtrimin nga kjo e fundit të funksionit të deputetes në kundërshtim me nenin 70, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës. Rezultonte nga dokumentet zyrtare se asokohe ministria dhe deputetja Olta Xhaçka kishte përfituar pasuri publike në emër të bashkëshortit të saj, si dhe në zbatim të një ligji të miratuar edhe me votën e saj dhe të bashkëshortit të saj (deputet në kohën e miratimit të ligjit) kishin përfituar statusin e investitorit strategjik, duke përfituar lehtësi fiskale për biznesin e tyre.

Në dhunim flagrant të Kushtetutës dhe vendimeve të mëparshme të Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 83, datë **17.11.2022**, Kuvendi vendosi mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka, ndërsa me vendimin nr. 84, datë 17.11.2022, vendosi miratimin e raportit të shumicës parlamentare, me objekt moskonstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka.

Në datën **18.11.2022** ne deputetët kërkues, që na u cënua një e drejtë kushtetuese, iu drejtua Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar mes pakicës parlamentare dhe Kuvendit.

Me vendimin **nr. 1, datë 23.1.2023**, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se: "... në zbatim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit ka të drejtë të paraqesë mocion për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit, ndërsa vendimmarrja e Kuvendit është e domosdoshme me qëllim vënien në lëvizje të kësaj Gjykate për t'u shprehur për themelin e çështjes, për sa kohë që pa një vendim të këtij organi Gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tilla.....Për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se në rastin konkret Kuvendi duhet të kishte pranuar mocionin e kërkuesit dhe të dërgonte çështjen për shqyrtim në këtë Gjykatë, në

mënyrë që aspektet e pretenduara si papajtueshmëri të mandatit të deputetes Olta Xhaçka t'i nënshtroheshin vlerësimit kushtetues, pasi gjatë gjykimit kushtetues nuk u verifikua ndonjë pengesë juridiko-formale që mocioni të pengohej nga Kuvendi. Bazuar në këto konsiderata, Gjykata çmon se vendimet e Kuvendit nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 për mosmiratimin e raportit përfundimtar të kërkuesit dhe miratimin e raportit përfundimtar të shumicës parlamentare për papajtueshmërinë e pretenduar të mandatit të deputetes, kanë cenuar të drejtën kushtetuese të një të dhjetës së deputetëve për të mos u penguar mocioni i tyre nga Kuvendi në kushtet e mosverifikimit të pengesave formale.”.

Në këto kushtet, me vendimin nr. 1/2023 Gjykata Kushtetuese ka vendosur pranimin e kërkesës së pakicës parlamentare, duke zgjidhur konfliktin e kompetencave me Kuvendin dhe duke shfuqizuar vendimet e këtij të fundit për mosdërgimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka në Gjykatën Kushtetuese.

Për analizimin e këtij vendimi, është mbledhur Këshilli i Legjislacionit, i cili në përputhje me Rregulloren e Kuvendit i ka paraqitur Raportin përkatës Kryetares së Kuvendit. Edhe pse vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i qartë, përsëri mazhoranca ka penguar zbatimin e vendimit nr. 1/2023 të Gjykatës Kushtetuese. Këtë bllokim të zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, vetë kjo gjykatë, më datë 05.02.2024, përmes Kryetares së Gjykatës Kushtetuese znj. Holta Zaçaj, e ka cilësuar si *“të paimagjinueshme në një shtet ligjor”* dhe se *“nuk ka ekuivoke në vendimet e GJK-së”*¹.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i është drejtuar disa herë zyrtarisht Kryetares së Kuvendit që të zbatojë vendimin e nr. 1/2023 të Gjykatës Kushtetuese. Këto kërkesa nuk janë marrë në konsideratë nga ana e shumicës parlamentare, duke cënuar jo vetëm të drejtat e pakicës parlamentare të garantuara nga neni 70 pika 4 e Kushtetutës, por duke cënuar edhe parimet bazë të shtetit ligjor, autoritetin dhe besimin e publikut tek Gjykata Kushtetuese dhe nenin 132 të Kushtetutës.

Ky pengim i zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për rastin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, vjen pas evidentimit të qartë të faktit se familja e saj ka përfituar statusin e investitorit strategjik me firmë të Kryeministrit Edi Rama, epror i saj, në kushtet flagrante të shkeljes së ligjit dhe konfliktit të interesit. Ky rast merr përmasat e një mbrojtjeje të pastër politike dhe pengimit të drejtësisë, po të mbahen në konsideratë edhe të dhënat e reja të hetuara dhe bëra publike nga SPAK². Nga ky hetim rezulton e provuar se pronësia mbi tokën është përfituar me dokumenta tërësisht të falsifikuara duke bërë të mundur që një tokë bujqësore, me një sipërfaqe në total prej 10.592 m2, e ndodhur në Dhërmi/Vlorë, në pronësi shtet, të tjetërsohet përmes transaksioneve tek të tretët në favor të subjektit privat në pronësi të bashkëshortit të deputetes Olta Xhaçka, duke zhveshur shtetin nga pronësia mbi të dhe duke përfituar me dokumente të falsifikuara statusin e investitorit strategjik nga Kryeministri Edi Rama dhe të drejtën për të zhvilluar një projekt me vlerë 5 milion euro në fushën e turizmit.

Ky është rasti i dytë i evidentuar në pak kohë, ku shtetit i grabiten me dokumente të falsifikuara pronësia në bregdet, për t'ia kaluar miqve apo bashkëpunëtorëve të Kryeministrit Edi Rama. Kujtojmë këtu se në një situatë identike 390 mijë metra tokë në pronësi të shtetit në plazhin e Velipojës, u përfituan përmes falsifikimeve nga miku i Kryeministrit Edi Rama, shtetasi i arrestuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar Pëllumb Gjoka, dhe ku më pas Kryeministri Edi Rama i miratoi një projekt investimi strategjik me vlerë 52 milion euro.

¹ *“E paimagjinueshme”*: Kushtetuesja kritikon moszbatimin e vendimit për Xhaçkën – Reporter.al

² NJOFTIM PËR SHITYP Datë 23.03.2024 - spak.gov.al

E ndërsa presim nga SPAK të hetojë në mënyrë të plotë dhe të gjithëanshme sesi këto dy subjekte private, me lidhje të ngushta me Qeverinë, përmes dokumenteve të falsifikuara kanë kaluar filtrat e kontrollit të ekzekutivit dhe kanë përfituar statusin e investitorit strategjik, duke evidentuar qartë rolin e Kryeministrit dhe të cilido tjetër që është përfshirë në këto raste, Kuvendi i Shqipërisë ka për detyrë jo vetëm të nxis SPAK të bëjë hetime të plotë dhe të paanshme, por të ndërmarrë vetë veprimet që i ka të detyrueshme sipas Kushtetutës, duke mos penguar drejtësinë në përmbushjen e rolit të saj kushtetues.

Nisur nga sa më lart, duke e konsideruar të papranueshme mbrojtjen politike dhe pengimin ndaj drejtësisë që mazhoranca po bën për rastin e ish-ministres dhe deputetes Olta Xhacka, duke penguar zbatimin prej 1 viti e 2 muaj të vendimit nr. 1/2023 të Gjykatës Kushtetuese, në mbështetje të pikave 1 dhe 2 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, ku specifikohet se: *“Konferenca e Kryetarëve diskuton dhe vendos për çështje të zhvillimit të punimeve të Kuvendit në seancë plenare.....Konferenca thirret ... me kërkesë të një prej kryetarëve të grupeve parlamentare”*;

KËRKOJ:

1. Zbatimin e vendimit nr. 1/2023 të Gjykatës Kushtetuese, duke evidentuar edhe motivet për pengimin e zbatimit të një vendimi drejtësie për një kohë të gjatë;
2. Thirrjen e mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve, me rend dite “Përfshirjen për shqyrtim në seancën më të afërt plenare të zbatimit të vendimit nr. 1/2023 të Gjykatës Kushtetuese, duke urdhëruar dërgimin e çështjes së mandatit të deputetes Olta Xhacka për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese”.
3. Konferenca e Kryetarëve të thirret brenda afatit 48 orë të përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit.

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Çdo vonesë e mëtejshme e kësaj çështje do të ishte dhunimi më flagrant që Kuvendi i ka bërë Kushtetutës në 33 vjet, si dhe një mesazh i qartë i vullnetit politik të mazhorancës socialiste për çimentimin e kulturës së pandëshkueshmërisë, përmes ofrimit të mbrojtjes politike ndaj deputetëve të mazhorancës dhe pengimit të zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetutes, institucion i dalë pas Reformës në Drejtësi dhe pjesë e asaj që sa herë i duhet për propagandë Kryeministrit e cilëson si “drejtësia e re”.

Duke shprehur edhe njëherë qëndrimin tonë se kjo çështje duhet të trajtohet me urgjencë, mbetemi në pritje të njoftimit tuaj për thirrjen e mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve sipas Rregullores së Kuvendit.

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

KRYETARI
Gazment BARDHI